VENDIM
Nr.366, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË SHKODËR TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.503, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Shkodër të qarkut të Shkodrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia: Shkodër Lidhja 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1,7,13-23	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
32-73	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e arsimit	Në pronësi
78-86,89-96	Prona që përdoren në fushën e shëndetësisë (shërbimi parësor)	Në pronësi
216,218-225 (pjesa e paprivatizuar e 225);228-234,241-243,579	Prona që përdoren në realizimin e programeve sportive dhe kulturore	Në pronësi
107-110,121-135,173-205,840-845	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
283-403	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
235, 241-248	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
621-631	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
404-535,536-566/4,567-571,572-577,581,582,580,619-620	Infrastrukturë vendore (rrugë, lulishte, trotuar sheshe)	Në pronësi
578	Shërbim funeral	Në pronësi